LIGJ
Nr.8403, datë 10.9.1998

PËR NJË SHTESË NË LIGJIN NR.8044, DATË 7.12.1995 "PËR KONKURRENCËN"

Në mbështetje te nenit 16, te ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e një grupi deputetësh

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.8044, datë 7.12.1995 "Për konkurrencën" në nenin 39, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje: "në fushën e medias së shkruar të pavarur nuk lejohet ulja e çmimit të shitjes së gazetave dhe revistave poshtë kostos së prodhimit të tyre."

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.